



Datë: 02.06.2025
Numër Protokolli:3794/2025

A.nr.356/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.356/2025, të datës 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesit N.G., Y.R. dhe A.X., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Shkelqim Jakupi, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimi/Agjencia për Menaxhimin Emergjent, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.356/2025 e datës 24.02.2025, **ashtu që detyrohet** Drejtori i Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të shqyrtoj Kërkesën e datës 26.12.2024, të parashtruar nga ankuesi N.G. dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.356/2025 të datës 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesit: Y.R. dhe A.X.

IV. Lënda e ankuesve sipas pikën III të dispozitivit të këtij vendimi bie në kompetencë dhe i dërgohet për shqyrtim organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent-Ministria e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesit, N.G., Y.R. dhe A.X.,(në tekstin e mëtejme referuar Ankuesit), përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat Shkelqim Jakupi, më datë 24.02.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 1194/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mosveprimeve apo heshtjes administrative të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, në ndërlidhje me Kërkesën e tyre të datës 26.12.2024, lidhur me korrigjimin e titullit të punës dhe përcaktimit të gradës në pagë, pagesën e orëve shtesë të punës gjatë javës, natës dhe festave zyrtare si dhe për pagesën e punës në vëllimin e shtuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Menaxhimin Emergjent, ndërsa kjo e fundit më datë 04.04.2024 dhe 10.04.2024 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2349/2025 të datës 08.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Drejtori i Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, të nxjerr akti administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës e datës 26.12.2024, të parashtruar nga ankuesi N.G., **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi N.G, sipas Akt emërimit të datës 10.01.2012, ka qenë i emëruar në pozitën e punës *Zyrtar i Preventives* pranë Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Pejës, ndërsa sipas Ndryshimit të aktit të emërimit të datës 01.08.2013, i njëjti ka kaluar në nivelin qendror në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave-MPB, në pozitën dhe pagë të njëjtë, respektivisht si *Zyrtar i Preventivës* në Njësinë e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë në drejtim të heshtjes administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës ku edhe ka gjetur se ankuesi më datë 26.12.2024 ka parashtruar kërkesë, përmes të cilës ka kërkuar korrigjimin e titullit të punës dhe përcaktimit të gradës në pagë, pagesën e orëve shtesë të punës gjatë javës, natës dhe festave zyrtare si dhe pagesën e punës me vëllim të shtuar, mirëpo nga shkresat e administruara të lëndës dhe thënieve si në ankesë rezulton se i njëjti nuk ka pranuar përgjigje nga organi përkatës i punësimit në raport me Kërkesën e datës 26.12.2024.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, nenit 98 paragrafi*

1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën me numër 26.12.2024, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, në raport me Kërkesën e datës 26.12.2024, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar tek organi i punësimit, ankuesi pretendon korrigjimin e titullit të punës dhe përcaktimit të gradës në pagë, pagesën e orëve shtesë të punës gjatë javës, natës dhe festave zyrtare si dhe pagesën e punës me vëllim të shtuar, dhe se organi përkatës i punësimit duhet të shqyrtoj kërkesën e tyre dhe të vendos lidhur me pretendimet e ngritura.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 24.02.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën e datës 26.12.2024, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë ***nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit Ylber Rudi dhe Arben Xërxa, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi Y.R, sipas Akt emërimit me numër protokolli 01 Nr.112-143/5 të datës 22.03.2012, ka qenë i emëruar në pozitën e punës *Shef i Preventivës* pranë Brigadës së Zjarrfikësve të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjakovës, ndërsa sipas Ndryshimit të aktit të emërimit të datës 01.08.2013, i njëjti ka kaluar në nivelin qendror në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave-MPB, në pozitën dhe pagë të njëjtë, respektivisht si *Zjarrfikës* në Njësinë e Shërbimit të Zjarrfikës dhe Shpëtimit.

Ndërsa, ankuesi A.X, sipas Akt emërimit me numër protokolli 01 Nr.112-14316 të datës 22.03.2012, ka qenë i emëruar *Oficer i Preventivës*, pranë Brigadës së Zjarrfikësve të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjakovës, ndërsa sipas Ndryshimit të aktit të emërimit të datës 01.08.2013, i njëjti ka kaluar në nivelin qendror në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave-MPB, në pozitën dhe pagë të njëjtë, respektivisht si *Oficer i Preventivës* në Njësinë e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, më datë 25.04.2025, ka kërkuar opinion ligjor nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, e cila më datë 18.05.2024, ka sqaruar se pozita **Zjarrfikës** dhe **Oficer i Preventivës**, nuk bëjnë pjesë në pozitat e shërbimit civil, andaj referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 5 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës..*, dhe si rrjedhojë konstatoi se ankuesit për shkak të pozicionit të punës që mbajnë aktualisht si, Zjarrfikës dhe Oficer i Preventivës, të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët nuk e ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, por të njëjtit e gëzojnë statusin e **Nëpunësit të shërbimit publik** sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, duke qenë se ankuesit nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit e lartë theksuar.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.289/2025 të datës 24.02.2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesit nuk e kanë shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda t'i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent-Ministria e Punëve të Brendshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën

Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.356/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit së autorizuar të ankuesve, Avokatit Shkelqim Jakupi;
- Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent-Ministria e Punëve të Brendshme;
- Komisionit për Ankesa të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent-Ministria e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.